



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.1209/9 prot.

Datë 20.05.2026

V E N D I M
Nr.679/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Gjergj Mersini	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 20.05.2026, mori në shqyrtim çështjen me,

- Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr.593/2026, datë 06.05.2026 për procedurën e prokurimit, “E hapur, e thjeshtuar” ,me Nr. REF-82022-04-15-2026, me objekt: “Blerje tonera” me fond limit 4,139,774.00 Lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 27-04-2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Marketing Distribution” shpk me NIPT J72124001N dhe adresë: Autostrada Tiranë -Durrës km 10.
- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Durrës, me adresë: Sheshi “Liria”, Qyteti Durrës
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik, i ndryshuar , Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 06.05.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 593/2026, ku vendosi:

- 1. Të mbyllë çështjen për ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Marketing Distribution” sh.p.k, në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-82022-04-15-2026, me objekt: “Blerje tonera” me fond limit 4,139,774.00 Lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 27-04-2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.*
- 2. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet e DST sipas konstatimeve të KSHA për procedurën e mësipërme të prokurimit*
- 3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.*
- 4. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Marketing Distribution” sh.p.k.*
- 5. Kopje e këtij vendimi t’i dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

I.2. Me shkresën nr. 1705/9 prot., datë 08.05.2026, protokolluar me tonën nr. 1209/6 prot., date 11.05.2026, autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës, njofton se ka bërë zbatimin e vendimit për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-82022-04-15-2026, me objekt: “Blerje tonera” me fond limit 4,139,774.00 Lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 27-04-2026 si dhe gjithashtu në vijim autoriteti kontraktor kërkon heqjen e pezullimit për procedurë objekt ankimi.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton:

II.1. Me shkresën nr. 1705/9 prot., datë 08.05.2026, protokolluar me tonën nr. 1209/6 prot., date 11.05.2026, autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës, njofton se ka bërë zbatimin e vendimit për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-82022-04-15-2026, me objekt: “Blerje tonera” me fond limit 4,139,774.00 Lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 27-04-2026 si dhe gjithashtu në vijim autoriteti kontraktor kërkon heqjen e pezullimit për procedurë objekt ankimi.

II.2. Referuar shkresës nr. 1705/9 prot., datë 08.05.2026, protokolluar me tonën nr. 1209/6 prot., date 11.05.2026, si dhe pas verifikimit të sistemit elektronik SPE rezulton se, autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës, ka publikuar shtojcën e modifikuar sikurse dhe njofton edhe në shkresë e sipërcituar.

II.3. Për sa më sipër, Komisioni konstaton se autoriteti kontraktor Bashkia Durrës, ka zbatuar vendimin Nr. 593/2026, datë 06.05.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit objekt ankimi “ E hapur, e thjeshtuar” , me Nr. REF-82022-04-15-2026, me objekt: “Blerje tonera” me fond limit 4,139,774.00 Lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 27-04-2026.

Përsa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” , me Nr. REF-82022-04-15-2026, me objekt: “Blerje tonera” me fond limit 4,139,774.00 Lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 27-04-2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro

